



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1119/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Zaskoku – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

**VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Bajram Zaskoku - Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Lipjan.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 13:55 nga parashtruesi i ankesës Bajram Zaskoku (LDK) ku pretendohet se, në fsh. Magurë, Janjevë, Rufc i Ri dhe Llugaxji të Lipjanit përkatësisht në Qendrat e votimit QV ka pasur bartje të votave të mija te kandidatët e tjerë për asamblë komunale. Më tutje ka shtuar se, gjatë procesit të numërimit të votave jamë i bindur se jamë dëmtuar, prandaj kërkoi sqarimin e dyshimeve të mia në këto QV. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur deklaratat e datës 03.12.2013 nga Nurdin Bytyqit, Hysen Bytyqit, Ilaz Krasniqit, Ahmet Gashit, Valon Jashanicës, Rexhep Rexhepit si dhe kopjet e leje njoftimeve të deklaruesve të lartpërmendur..

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Bajram Zaskoku (LDK), pretendohet se n QV ka pasur bartje të votave të tij në kandidatët e tjerë, mirëpo nga pretendimet ankimore si dhe nga deklaratat e deklaruesve PZAP-i nuk ka mundur që të vërtetohet se është kryer një veprim i tillë, prandaj një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u

bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1119/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.